



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:089769
Datë: 09.12.2024
Numri i dokumentit: 06568901

PML.nr.527/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Mejreme Memaj, anëtare, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit E. M., nga P., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.177/2019 të datës 07.03.2024 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.280/2024 të datës 19.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit E. M., ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.177/2019 të datës 07.03.2024 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.280/2024 të datës 19.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.177/2019 të datës 07.03.2024, i dënuari E. M., është shpallur fajtor për

shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale, i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i dënuari në afta prej 2 (dy) vite, nuk kryen vepra të re penale, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 19.06.2013 e deri më datën 19.11.2013, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilën gjobë është obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse dënimi me gjobë, nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapare me nenin 43 par.3 të KPRK-së, atëherë, dënimi me gjobë do t'i shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 € të gjobës së shqiptuar, të dënuarit do t'i llogaritet një ditë burgim.

I dënuari është obliguar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € si dhe 50 € në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PAKR.nr.280/2024 e datës 19.06.2024, është refuzuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E. M., avokati Alban Makolli, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.306/2024 e datës 29.08.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e pabazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, avokati Alban Makolli, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e duke mos i cekur shkeljet konkrete por duke i ndërlidhur me shkelje të ligjit penal. Kështu, mbrojtja konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka shkel nenin 12 par.1 dhe par.2 të KPRK-së, pasi që në veprimet e të dënuarit manifestohen rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale, ngase këto veprime janë kryer në mbrojtje të nevojshme e po ashtu është shkelur edhe neni 17 par.1 të KPRK-së, meqë tek i dënuari mungon dashja për kryerjen e veprës penale. Duke u nisur nga fakti se i dënuari ka shtënë me armë, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë së tij nga veprimet e paligjshme të personit T. A.T., i

cili kishte i kishte marrë paraprakisht të dënuarit shumën prej 43,000.00 €, e cili veprim është veprim sulmues ndaj pasurisë së të dënuarit. Pra, përveç integritetit fizik, edhe nëse sulmohet pasuria e njeriut, atëherë kemi të bëjmë me sulm të kundërligjshëm, të atëçastshëm, drejtuar kundër pasurisë dhe i dënuari duke u gjendur në këtë situatë, ka shtënë në ajër me qëllim të frikësimit të personit i cili ishte duke ikur me shumën e parave të cekur më lartë. Sa i përket, gjykatës së shkallës së dytë, mbrojtja, pretendon se është shkelur neni 404 i KPP-së, pasi që gjykata nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e ankesës dhe shkeljeve që i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimet nuk janë të janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Kështu, dispozitivet e aktgjytimeve janë të qarta, konkrete dhe nuk përmbajnë kundërthënie qoftë me vetveten, qoftë me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose si të pa provuara dhe duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitës së nenit 369 të KPP-së. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye lidhur me të gjitha pretendimet ankimore sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat e të cilat i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare e duke mos gjetur shkelje të cilat do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Andaj, është i pabazuar pretendimi se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar dhe arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore të mbrojtësit të dënuarit.

Gjykata Supreme po ashtu, vlerëson se dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë është i qartë, i kuptueshëm dhe në përputhshmëri me dispozitat e nenit 369 të KPPS-së dhe në dispozitiv janë përfshirë të gjitha rrethanat dhe faktet nga të cilat përmbushen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale përdorimi i armës ,apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, e për të cilën vepër penale i dënuari edhe është shpallur fajtor.

Nga provat e administruara dhe të vlerësuara nga dy gjykatat si dhe bazuar në vet pohimet e të dënuarit, në seancën gjyqësore dhe gjatë hetimeve, drejtë është konkluduar se i njëjti ka shtënë në ajër, njëherë, me qëllim të frikësimit të dëmtuarit, i cili më parë me lajthim i kishte marrë një shumë të parave dhe gjatë ndjekjes së tij e kryen këtë veprim. Por, i dëmtuari nuk i kishte marrë parat duke e sulmuar, ashtu sikur pretendohet në kërkesë, sepse i dënuari dhe i dëmtuari kishin një marrëveshje biznesi, së bashku edhe me një person të, quajtur B., i cili së bashku me paratë kishte ikur dhe tani i dënuari së bashku personin B. M., e kishin ndaluar me forcë të dëmtuarin, duke kërkuar nga ai paratë e humbura, ndërsa gjatë ikjes së të dëmtuarit T., i dënuari shtënë me ramë në ajër e me qëllim të frikësimit dhe ndalimit të tij. Pra, as i dënuari e as pasuria e tij ,nuk ishte e sulmuar, ashtu si pretendohet pa bazë në kërkesë, dhe nuk mund të bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme. Instituti i mbrojtjes së nevojshme mund të aplikohet vetëm atëherë kur është i kundërligjshëm , i drejtuar kundër çdo të mire dhe

i atëçastshëm, ndërsa në rastin konkret nuk është plotësuar asnjë nga kushtet e parapa ligjore me dispozitën e nenit 12 të KPRK-së, sepse i dëmtuari nuk e kishte sulmuar as të dënuarin e as pasurinë e tij e sidomos jo në momentin kur ai ka shtënë me armë. Nuk është kontestuese se i dënuari dhe i dëmtuari kishin mosmarrëveshje lidhur me një “biznes”, por ato ishin çështje dhe konteste kontraktuale, të cilat mund të zgjidhen para organeve kompetente, andaj pretendimet se i dënuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme janë të pabazuara dhe në dëm të dënuarit nuk është shkelur ligji penal.

Edhe pretendimet se tek i dënuari ka munguar dashja, janë të pabazuara, sepse vet i dënuari e pohon dhe vërteton se ka shtënë me armë me qëllim të frikësimit, pra ka pasur dashje për këtë veprim, e që ky është edhe elementi qenësor i veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 437 të KPP-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.527/2024, më 22 nëntor 2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi